



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

Udhëzues në lidhje me akreditimin sipas skemës së certifikimit ISO 20121 Sistemet për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve – Kërkesa me udhëzime për përdorim.

Kodi: DA – IN-028

Rishikim nr 0
Dt: 30.06.2023

Faqe 1 of 8

Udhëzues në lidhje me akreditimin sipas skemës së certifikimit ISO 20121 Sistemet për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve – Kërkesa me udhëzime për përdorim.

Zbatues: Stafi i DPA-së, të gjitha Organet e Vlerësimit të Konformitetit të akredituara dhe aplikantët

Përgjegjës për zbatim: Drejtori i Drejtorisë së Organeve Certifikuese dhe Inspektuese

Kontrolloi: Ardita MELE
Menaxheri i Cilësisë

Miratoi: Pranvera FAGU
Drejtori i Përgjithshëm



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

Udhëzues në lidhje me akreditimin sipas skemës së certifikimit ISO 20121 Sistemet për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve – Kërkesa me udhëzime për përdorim.

Kodi: DA – IN-028

Rishikim nr 0
Dt: 30.06.2023

Faqe 2 of 8

1. QËLLIMI

Ky dokument përshkruan udhëzime për akreditimin sipas ISO 20121:2012. Ky dokument është i vlefshëm për DPA dhe vlerësuesit e saj si dhe për organet certifikuese të sistemeve për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve të akredituar nga DPA, organet certifikuese të sistemeve për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve, që kanë aplikuar për akreditim apo që kanë për qëllim të aplikojnë për akreditim.

2. FUSHA E ZBATIMIT

Ky udhëzues zbatohet nga vlerësuesit dhe stafi i DPA, nga nënkontraktuesit e saj për vlerësimin e organeve certifikuese që kryejnë certifikim të sistemeve të menaxhimit të qëndrueshëm të eventeve në përputhje me këtë standard.

3. PËRGJEGJËSITË

Ky udhëzues është pjesë e sistemit të menaxhimit të DPA dhe si i tillë është nën përgjegjësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit rishikimi i vazhdueshëm në varësi të ndryshimeve të duhura dhe përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin e menaxhimit të DPA. Është detyrë e Drejtorit të Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese të kontrollojë zbatimin e këtij udhëzimi.

4. REFERENCA

ISO 20121:2012, Sistemet e menaxhimit të qëndrueshëm të eventeve – Kërkesa me udhëzime për përdorim.

ISO 17021-4: 2013, Vlerësimi i konformitetit – Kërkesat për organizmat që ofrojnë auditim dhe certifikim të sistemeve të menaxhimit – Pjesa 4. Kërkesat e kompetencës për auditimin dhe certifikimin e sistemeve për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve.

Politikat dhe rregulloret e zbatueshme të DPA-së.

Dokumentet e Detyrueshme IAF, sipas zbatueshmërisë.

5. FJALORI DHE SHKURTIME

Në këtë udhëzues është përdorur terminologjia nga standardi ISO/IEC 17011:2017
IAF Forum Ndërkombëtar i Akreditimit
DPA Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
Standardet e posaçme të renditura më sipër.



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

Udhëzues në lidhje me akreditimin sipas skemës së certifikimit ISO 20121 Sistemet për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve – Kërkesa me udhëzime për përdorim.

Kodi: DA – IN-028

Rishikim nr 0
Dt: 30.06.2023

Faqe 3 of 8

6. PËRMBAJTJA

6.1. Të përgjithshme

Standardi ISO 20121:2012 rrjedh drejtpërdrejt nga standardi britanik BS 8901 “Specifikime për një sistem menaxhimi të qëndrueshëm të eventeve”, që ishte standardi britanik për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të qëndrueshëm të ngjarjeve. Standardi ISO përcakton kërkesat specifike për organizatat që merren me organizimin e ngjarjeve, të cilat duan të pakësojnë ndikimin në mjedis dhe komunitet dhe që forcojnë marrëdhëniet me palët e interesuara: autoritetet vendore, furnitorët, klientët, punonjësit dhe sigurisht edhe me pjesëmarrësit dhe përdoruesit e ngjarjes.

Standardi u drejtohet jo vetëm organizatave që merren me organizimin e ngjarjeve si biznes parësor (p.sh. qendrat e ekspozitave, organizatorët e panairove, qendrat e konferencave, teatrot, kinematë, shoqëritë e shërbimeve të kateringut, biznesit të muzikës dhe spektakleve, agjencitë e komunikimit), por të gjitha organizatave që kanë për qëllim të zbatojnë ose përmirësojnë aftësinë e tyre për të organizuar ngjarje në mënyrë të qëndrueshme (p.sh. mbledhjet ose asambljet).

Ngjashmëritë dhe ndryshimet me standardin ISO 14001: të dy janë standarde menaxhimi dhe kërkojnë një “analizë fillestare të rëndësisë”, standardi ISO 20121 merr në konsideratë jo vetëm dimensionin mjedisor, por edhe atë ekonomik dhe shoqëror.

Duhet mbajtur parasysh se nuk është ngjarja në vetvete që duhet të jetë në përputhje me standardin, por sistemi i menaxhimit (shiko përshkrimin e qëllimit të standardit ku fokusi është “menaxhimi i qëndrueshëm”). Një organizatë mund të vendosë të zbatojë standardin për të gjitha ngjarjet, për një ngjarje të vetme, ose për një grup ngjarjesh. Rrjedhimisht, veprimtaritë e certifikuar duhet të përcaktojnë me saktësi nëse sistemi i organizatës është i zbatueshëm për një ngjarje (p.sh. një veprimtari sportive e veçuar), ose për një lloj ngjarjesh (p.sh. turne sportive ose gara me makina).

Standardi ISO 20121 “Sistemet për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve – Kërkesat dhe udhëzimet për përdorim” është standardi i posaçëm për këtë sektor. Përveçse bazohet në parimet e konsoliduara të sistemeve të menaxhimit, ai përfshin elementë karakteristike të standardit ISO 26000, dhe përfshin lloje të ndryshme ngjarjesh: nga ngjarjet e mëdha sportive e deri te “orët e gëzuara” (“happy hour”) të një vinoteke.

6.2. Rregulla për procesin e certifikimit

Standardi i akreditimit	ISO/IEC 17021-1:2015
Standardi i certifikimit	ISO 20121:2012
Kriteret e kompetencës	Shiko standardin ISO/IEC 17021-4:2013 “Vlerësimi i konformitetit – Kërkesat për organizmat që ofrojnë auditimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit – Pjesa 4. Kërkesat e kompetencës për auditimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit të qëndrueshmërisë të eventeve”. Grupi i auditimit duhet të jetë kompetent edhe për aspektet ekonomike dhe sociale të një organizate.



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

Udhëzues në lidhje me akreditimin sipas skemës së certifikimit ISO 20121 Sistemet për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve –
Kërkesa me udhëzime për përdorim.

Kodi: DA – IN-028

Rishikim nr 0
Dt: 30.06.2023

Faqe 4 of 8

Paanshmëria	Paanshmëria duhet të vlerësohet edhe duke iu referuar ngjarjes së veçantë, përfshirë sponsorët.
Llojet e subjekteve që mund të kërkojnë certifikimin	3 lloje subjektësh mund të kërkojnë certifikimin: a) Organizata përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm të ngjarjes. b) Organizatat që ofrojnë shërbime që mund të përfshihen në evente si p.sh. shoqëritë e shërbimeve catering, të fuqisë punonjëse sezonale, hostess, të shërbimeve të sigurisë fizike, të furnizimit me energji, të shërbimeve higjieno-sanitare, shoqëritë e konsulencës apo të marketingut. c) Strukturat dhe platformat ku mund të zhvillohen ngjarje, të tilla si: qendra panairesh, qendra konferencash, hotele, stadione, pallate sporti, zona dhe struktura në pronësi private ose publike.
Auditimet për certifikim dhe lidhja me fushën e certifikimit	<u>Shënim për Fazën 1 të auditit</u> <ul style="list-style-type: none">▪ Mund të certifikohet vetëm sistemi i menaxhimit të një <u>ngjarjeje e përcaktuar si e tillë nga ISO 20121 në pikën 3.8.</u> Prandaj nevojitet të konfirmohet në Fazën 1 nëse ngjarja, për të cilën kërkohet certifikimi, është e certifikueshme.▪ Duhet të përcaktohet në mënyrë specifike personi juridik kontraktualisht i identifikueshëm në certifikatë si përgjegjës kryesor në menaxhimin e qëndrueshëm të ngjarjes (drejtuesit e sistemit për sa u përket parimeve, politikës dhe fushës).▪ Vëmendje të veçantë duhet t’u kushtohet aspekteve kontekstuale tipike për sektorin e ngjarjeve (p.sh. leje për mbajtjen e ngjarjes, të drejtat e autorit).▪ Organi certifikues duhet të konfirmojë kompetencat specifike të grupit të auditimit, pasi të ketë identifikuar fushëveprimin dhe objektivat që ka përcaktuar organizata. <p>Kur kryhet auditimi i veprimtarive pas ngjarjes (feedback nga palët e interesuara ose raportimi, nëse parashihet), organi certifikues duhet të mbledhë nga mediat të dhëna mbi ngjarjen, nëse ka.</p> <p>Auditimet për certifikim dhe fusha e certifikimit ndryshojnë në varësi të subjektit që kërkon certifikimin.</p>
Kohëzgjatja e auditit dhe shpeshësia e veprimtarive audituese	Të përgjithshme Zbatohet <u>Tabela 1 (EMS, Risku i Ulët) nga IAF MD 05</u> , pa bërë asnjë ulje. Jo më pak se 80 % e kohës duhet të shpenzohet për veprimtaritë audituese në vend (on site). Pjesa tjetër e kohës, jo më shumë se 20% së mbetur mund të përdoret për veprimtaritë e tjera (off site).



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

Udhëzues në lidhje me akreditimin sipas skemës së certifikimit ISO 20121 Sistemet për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve –
Kërkesa me udhëzime për përdorim.

Kodi: DA – IN-028

Rishikim nr 0
Dt: 30.06.2023

Faqe 5 of 8

Gjejnë zbatim klauzolat për rritjen e kohëve të auditimit (veçanërisht ato që lidhen me kampionimin e ngjarjeve).

Një tjetër situatë në të cilën është e nevojshme rritja e kohëve të auditit mund të ndodhë kur paraqitet një veprimtari raportimi veçanërisht komplekse.

Llogaritja e numrit të punonjësve dhe shpeshësia e kryerjes së auditimeve ndryshon në varësi të subjektit që kërkon certifikimin.

Kohëzgjatja e auditimeve të mbikëqyrjes dhe ricertifikimit nuk duhet të ndjekë me patjetër rregullat e IAF MD 05 (1/3 dhe 2/3 e auditimit fillestar), por mund të përshtatet sipas veprimtarive konkrete që zhvillon organizata. Një situatë e tillë mund të zbatohet, për shembull, për organizatat që menaxhojnë ngjarjet që zhvillohen çdo dy vjet (sezonaliteti). Pavarësisht nga kohëzgjatja e auditimeve të veçanta, koha përmbledhëse për trevjeçarin duhet të jetë në përputhje me rregullat e sipërpërmendura të dokumentit IAF MD 05.

a) Organizata përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm të eventit.

Është e nevojshme të merret në konsideratë personeli që bashkëpunon me organizatën duke përdorur kriteret e miratuara për skemën ISO 14001 për llogaritjen e punonjësve dhe të numrit të barasvlefshëm për punonjës me kohë të plotë (Full-Time Equivalent).

Nëse një organizatë përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm certifikohet pa një ngjarje specifike (pra, në certifikatën e organizatës përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm nuk do të referohet asnjë ngjarje e veçantë), përveç zbatimit të IAF MD 05, kërkohet që në ciklin e certifikimit, të auditohet të paktën një ngjarje (ofrim shërbimi) gjatë kohës që ajo zhvillohet. Zgjedhja e ngjarjes/ngjarjeve të kampionuara duhet të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme sipas rëndësisë dhe rrezikut. Mbikëqyrjet kryhen çdo vit.

Çdo ndryshim në kohët e llogaritura të auditimit për ngjarjet mund të pranohet, nëse organi certifikues, përmes të dhënave të marra në Fazën 1, garanton një kampionim të përshtatshëm mbi bazën e këtyre aspekteve: fusha, objektivat dhe synimet (duke përfshirë rreziqet dhe mundësitë), palët e interesuara, rëndësia dhe sasia e ngjarjeve. Këto vendime dokumentohen dhe duhet t'i paraqiten grupit të akreditimit në fazën e mbikëqyrjes në selinë përkatëse.

Nëse është një ngjarje e vetme, certifikata do të mbajë si datë skadence atë datë, që përkon me kohën e përfundimit të ngjarjes, duke përfshirë dhe fazën e feedback-ut ose të raportimit, kur parashikohet nga organizata përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm.

Për mbikëqyrjet, në rastet kur ngjarjet janë periodike, (p.sh: panairët 6-mujore,



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

Udhëzues në lidhje me akreditimin sipas skemës së certifikimit ISO 20121 Sistemet për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve –
Kërkesa me udhëzime për përdorim.

Kodi: DA – IN-028

Rishikim nr 0
Dt: 30.06.2023

Faqe 6 of 8

vjetore, ose që zhvillohen çdo dy vjet) shpeshësia e auditimeve për organizatat dhe ngjarjet mund të përshtatet në bazë të kalendarit të edicioneve të ndryshme të së njëjtës ngjarje ose të ciklit të menaxhimit të ngjarjes.

Duhet të kryhet të paktën një audit në vit (siç përcaktohet nga ISO 17021), ndërsa kohëzgjatja e auditeve mund të ndryshojë.

Gjatë ciklit të mbikëqyrjes, organizata përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm duhet të dëshmojë zbatimin e standardit për ngjarjet e përfshira në certifikatë. Organi certifikues duhet të kryejë të paktën një inspektim gjatë zhvillimit të çdo ngjarjeje të përfshirë në certifikatë, gjatë ciklit trevjeçar të certifikimit (përveç rastit kur shpeshësia e ngjarjes është më e rrallë se çdo tre vjet).

Fusha e certifikimit mund të zgjerohet mbi bazën e të njëjtave kritereve të përdorura në auditin e certifikimit.

Më poshtë paraqitet shënimi i shtuar në pikën 9.3.2.2 të draftit të ISO 17021-1:2015
Shënim: Mund të jetë e nevojshme të rregullohet shpeshësia e auditit të mbikëqyrjes për të përshtatur faktorë të tillë si stinët ose certifikimin e sistemeve të menaxhimit me kohëzgjatje të kufizuar.

b) Organizatat që ofrojnë shërbimet për eventet (p.sh. shoqëritë e shërbimeve të kateringut, punë sezonale, hostess, shërbimet e sigurisë, furnizim me energji, shërbimet e konsulencës dhe marketingut).

Është e nevojshme të merret parasysh personeli që bashkëpunon me organizatën, sipas skemës për sistemet e menaxhimit të mjedisit.

Duhet të kryhen të paktën 2 mbikëqyrje në ciklin e certifikimit, me ricertifikim në fund të periudhës trevjeçare. Gjatë mbikëqyrjes organizata duhet të krijojë kushtet që grupi i certifikimit të mund të kryejë të paktën një inspektim gjatë një ngjarjeje.

c) Strukturat dhe platformat ku mund të zhvillohen ngjarje (p.sh. panairë, qendra konferencash, hotele, stadione, pallate sporti, zona dhe struktura në pronësi private ose publike).

Është e nevojshme të merret parasysh personeli që bashkëpunon me organizatën, sipas skemës për sistemet e menaxhimit të mjedisit.

Duhet të kryhen të paktën 2 mbikëqyrje në ciklin e certifikimit, me ricertifikim në fund të periudhës trevjeçare. Gjatë mbikëqyrjes organizata duhet të krijojë kushtet që grupi i certifikimit të mund të kryejë të paktën një inspektim gjatë një ngjarjeje. Përzgjedhja e ngjarjes bëhet nga organi certifikues sipas vlerësimit të riskut.

Menaxhimi i moskonformiteteve

Kur identifikohen moskonformitete madhore (sipas përcaktimit në ISO 17021-1:2015, 3.12) gjatë auditit (të tilla mund të jenë edhe veprimtari të palicencuara gjatë ngjarjes, tejkalim i kapaciteteve të lejuara të një stadiumi etj.), organi certifikues duhet:

- Të heqë nga certifikata referencën për ngjarjen.



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

Udhëzues në lidhje me akreditimin sipas skemës së certifikimit ISO 20121 Sistemet për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve – Kërkesa me udhëzime për përdorim.

Kodi: DA – IN-028

**Rishikim nr 0
Dt: 30.06.2023**

Faqe 7 of 8

	<ul style="list-style-type: none">▪ Të vlerësojë ndikimin, që ka për rillogaritjen e kohëve të auditit për eventet pasuese.▪ Nëse gjetja përsëritet edhe në evente të tjera, organi certifikues duhet të vlerësojë tërheqjen e certifikatës nga organizata përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm.▪ Organizata përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm ose organizata të tjera të lidhura me ngjarjen (ose ngjarjet) nuk lejohen të përdorin asnjë referim ndaj certifikimit të mëparshëm. <p>Kur organizata përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm është përfshirë në çështje ligjore që lidhen me fushën e certifikimit (p.sh. menaxhim i mbetjeve, siguria në punë, ndotje mjedisi, zhurma etj.), është përgjegjësi e organit certifikues të vlerësojë më kujdes veprimtaritë e kryera nga organizata për të shmangur përsëritjen e situatave që kanë shkaktuar çështjen ligjore, përfshirë çdo veprim parandalues dhe përmirësues.</p> <p>Në këto raste është gjithmonë e nevojshme kryerja e auditeve shtesë, para se të konfirmohet lëshimi ose mbajtja e certifikimit.</p>
Certifikata	<p>Certifikata duhet t'i referohet gjithnjë standardit ISO 20121.</p> <p>Një organizatë përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm mund të certifikohet edhe pa një ngjarje specifike (pra, në certifikatën e organizatës përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm nuk do të referohet asnjë ngjarje e veçantë).</p> <p>Në certifikatë duhet të jepen produktet, shërbimet apo proceset e mbuluara nga sistemi i certifikuar.</p>

6.3. Procesi i akreditimit

Mund të paraqiten raste të ndryshme, bazuar në akreditimet e zotëruara nga organizmi i certifikimit që kërkon akreditim ose zgjerim. Vlerësimi i DPA për organet që aplikojnë për këtë skemë ose që janë të akredituar për këtë skemë do të bëhet si më poshtë:



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

Udhëzues në lidhje me akreditimin sipas skemës së certifikimit ISO 20121 Sistemet për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve – Kërkesa me udhëzime për përdorim.

Kodi: DA – IN-028

Rishikim nr 0
Dt: 30.06.2023

Faqe 8 of 8

Veprimtaria akredituese	Mënyra e vlerësimit	Kohëzgjatja e vlerësimit
Akreditim fillestar për skemën ISO 20121	Vizitë në vend ku do të vlerësohet kompetenca e auditorëve dhe kryhet vlerësim vertikal. Vlerësim me dëshmi (audit për certifikim fillestar).	Të paktën 2 ditë Varet nga kohëzgjatja e vizitës audituese.
Mbikëqyrjet: Gjatë ciklit të akreditimit do të kryhet të paktën një vizitë në zyrë dhe një vlerësim me dëshmi. Gjatë ciklit të akreditimit, organi certifikues duhet t'i krijojë mundësi grupit të vlerësimit të marrë pjesë të paktën në një inspektim gjatë një ngjarjeje. Përzgjedhja e ngjarjes bëhet nga grupi i vlerësimit sipas vlerësimit të riskut.	Vizitë në vend (vlerësim i kompetencës së auditorëve dhe vlerësim vertikal). Vlerësim me dëshmi (audit për certifikim fillestar).	Të paktën 1 ditë Varet nga kohëzgjatja e vizitës audituese
Zgjerim për skemën ISO 20121	Vizitë në vend (vlerësim i kompetencës së auditorëve dhe vlerësim vertikal). Vlerësim me dëshmi (audit për certifikim fillestar).	Të paktën 1,5 ditë Varet nga kohëzgjatja e vizitës audituese.

Për organet me shumë vendndodhje

Për akreditim fillestar/zgjerim: të gjitha vendet ku kryhen aktivitetet kryesore do të vlerësohen me vizitë në vend.

Gjatë ciklit të akreditimit: vendet ku kryhen aktivitetet kryesore do të vlerësohen të paktën një herë në dy vjet me vizitë në vend. Vendet e tjera do të vlerësohen të paktën një herë në ciklin e akreditimit me vizitë në vend.